




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË MBROJTJES PËR VITIN 2024

Prishtinë, maj 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Mbrojtjes (MM), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Mbrojtjes, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Mbrojtjes kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Në gjashtë (6) raste kishte vonesa në furnizim me produkte/mall sipas kushteve të kontratave nga 13 deri në 55 ditë. Vonesat ishin të ndikuara kryesisht nga Autoriteti Kontraktues si rezultat i mos krijimit të parakushteve për pranim apo pengesa tjera administrative.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Kontratat dhe pagesat në kategoritë si investime kapitale dhe mallra shërbime të cilat ishin të klasifikuara (niveli i kufizuar) nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, nuk janë pjesë e këtij raporti. Këto kontrata dhe pagesa auditohen ndaras dhe përgatitet një raport i veçantë i auditimit i cili do të ju komunikohet vetëm palëve përgjegjëse. Përderisa lëndët që e kanë nivelin e klasifikimit Sekret dhe Konfidencial nuk janë audituar.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Mbrojtjes është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Mbrojtjes.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Mbrojtjes është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Mbrojtjes në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Mbrojtjes.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ministria në vitin aktual ka shpenzuar rreth 97% të buxhetit final apo 169,781,668€ me një rritje të realizimit prej 10% krahasuar me vitin paraprak. Fushat me problemet më të theksuara kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratave që kishin të bënin me vonesat në furnizim/ liferim të mallit apo produkteve për punë si rezultat i mos krijimit të kushteve nga ana e autoritetit kontraktues dhe si pasojë e pengesave tjera administrative.

Mangësi tjera në menaxhimin e financave ishin edhe kompensimi jo i plotë për punën jasht orarit, tejkalim i afatit ligjor për ushtrues të detyrave dhe mangësi në menaxhimin e barnave dhe të prokurimit.

Sfidë mbetet ende prezantimi jo i drejtë dhe jo i plotë pasurive nën 1000€ dhe detyrimeve kontingjente në Pasqyra financiare si rezultat i mosazhurnimit të regjistrave me informatat e fundit.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja, një (1) rekomandim i përsëritur dhe dy (2) pjesërisht të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Vonesa në përmbushjen e kontratave

Gjetja

Afatet dhe kushtet e liferimit të produkteve/mallit janë të definuara me kontratë dhe afati për dorëzim, do të llogaritet nga koha e lëshimit të urdhërblërjes nga ana e Autoritetit Kontraktues (AK). Në rastet kur Operatori ekonomik nuk arrin që t'i dorëzoj produktet, shërbimet ose punët sipas kushteve të kontratës AK do të ketë të drejtë që të aplikoj penalet. Ne identifikuam se:

- Furnizimet me çizme në vlerë 629,660€ ishin bërë me një vonesë prej 44 përkatësisht 55 ditë. Pas nënshkrimit të kontratës AK kishte bërë porosinë e mallit me datën 29.04.2024 kurse pranimi i mallit ishte bërë në dy pjesë me datë 10.10.2024 dhe 21.10.2024. Afati për furnizim sipas kontratës ishte 120 ditë. Tenderi për furnizim me çizme ishte nisur dy vite më herët por që për shkak të ankesave në OSHP ishte prolonguar procesi i dhënies së kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës, në kohën kur ishte bërë porosia OE kishte kërkuar modelin e mostrës me të cilën kishte ofertuar në Ministri. Zyrtarët përgjegjës kishin hezituar dhënien e mostrës dhe dakordimi për t'ia ofruar mostrën OE kishte marrë kohë. Penalet për vonesa nuk ishin zbatuar nga ana e Ministrisë përshkak të rrezikut real të humbjes së rastit në gjykatë nëse OE do të ankohej pasi që edhe Ministria kishte pasur ndikimin e vet në këto vonesa;
- Furnizimi me pjesë kamioni në vlerë 4,402€ ishte bërë me vonesë 45 ditë. Afati i liferimit për pjesë rezervë sipas nenit 2 të kontratës ishte: për pjesën A të furnizimeve 15 ditë, kurse pjesën B 60 ditë nga momenti i porosisë. Furnizimi i pjesës A ishte bërë me 45 ditë vonesë, pasi që OE kishte bërë furnizimin sipas kriterit të pjesëve B. Ministria nuk kishte zbatuar penalet siç parasheh kontrata duke e justifikuar vonesën e OE-së;
- Furnizimi me uniformë për kadet në vlerë 19,378€ ishte bërë me 13 ditë vonesë si pasojë e mungesës së komunikimit adekuat. Urdhërblerja nga AK ishte dërguar në një email jofunksional të operatorit ekonomik, dhe në kohën e dërgimit nuk kishte pasur ndonjë komunikim tjetër për të konfirmuar nëse porosia kishte arritur në adresën e duhur. Menaxheri i kontratës nuk ishte siguruar me kohë për këtë lëshim teknik nga ana e tyre;
- Furnizimi me emblema dhe grada ushtarake në vlerë 29,999€ ishte bërë me 34 ditë vonesë. Sipas nenit 2 të kontratës afati për dorëzim ishte 30 ditë nga momenti i lëshimit të urdhërblërjes. Vonesa kishte ndodhur pasi që AK përkundër porosisë që e kishte bërë kërkonte shtyrje të afatit për pranimin e mallit (me arsyetimin e angazhimeve tjera dhe se kryesuesi i komisionit ishte në pushim). Më tutje, AK kishte kërkuar nga OE të bëjë ndryshimin e dy pozicioneve e për këtë arsye, OE më pas kërkoi shtyrje të afatit prej 2-3 javësh për realizimin e këtij ndryshimi. Porosia ishte bërë me dt. 26.02.2024, kurse pranimi i mallit më dt. 30.04.2024;

Po ashtu, te furnizimi tjetër me emblema, shenja dhe grada në vlerë 20,037€ kishte vonesa në pranimin e mallit për 13 ditë, pasi që vendimi për caktimin e komisionit të pranimi të mallit ishte bërë me

vonesë; dhe

- Furnizimi me gypa plastik në vlerë 18,900€ ishte bërë me 17 ditë vonesë, për shkakun që Ministria nuk kishte krijuar kushtet e nevojshme për pranimin e mallit, dhe kishte kërkuar nga OE të mos e bëjë furnizimin përkundër porosisë që e kishte bërë.

Vonesat në liferim të mallit kishin ndodhur kryesisht si rezultat i menaxhimit jo të mirë nga ana e menaxherëve të kontratave, vonesës në emërimin e komisionit për pranimin e mallit dhe si pasojë e moskrijimit të parakushteve për pranimin e mallit nga Ministria.

Ndikimi

Vonesat në liferimin e mallit ishin të ndikuara kryesisht nga ana e Ministrisë edhe pse afatet për liferim kishin qenë kritere në momentin e përzgjedhjes së operatorit fitues dhe ishin kushte të kontratës. Këto vonesa reflektojnë në mos arritjen e objektivave të parapara me buxhetin e vitit aktual, e që problemet e tilla mund të sjellin edhe vështirësi financiare për vitin e ardhshëm fiskal.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherëve përkatës që janë ndërmarrë veprimet konkrete dhe me kohë për eliminimin e barrierave të ndryshme dhe krijimin e parakushteve për pranimin e mallit duke mundësuar përmbushjen e secilës kontratë sipas afateve të përcaktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje është 42,356,760€, prej tyre janë shpenzuar 42,353,950€ apo rreth 100%.

Çështja A2 - Dobësi në menaxhimin e proceseve në fushën e personelit

Gjetja

Menaxhimi i proceseve në fushën e personelit si rekrutimi dhe zëvendësimi i personelit duhet të zhvillohet në përputhje me rregullat dhe kriteret e përcaktuara ligjore. Ne identifikuam se:

- Në konkursin për pozitën zyrtar i pasurisë, ishte kërkuar përvojë pune profesionale së paku një (1) vit, e cila duhet të mbështetet me dëshmitë si në vijim: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale.

Nga dëshmitë e testuara vërehet se stafi i pranuar për këtë pozitë kishte ofruar dëshmi të mjaftueshme mbi përvojën e punës, por jo relevante pasi që përvoja e dëshmuar (kontrata e punës dhe Trusti pensional) nuk ishte në fushën profesionale, por ishte në fushën e gastronomisë; dhe

- Ligji për Zyrtar Publik Nr.08/L-197 në nenin 35 pikën 3 thekson se zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se gjashtë muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë.

Në dy raste identifikuam se kishte tejkalim të afatit ligjor për mbajtjen e pozitës si ushtrues detyre. Pozitat mbaheshin me ushtrues detyre që nga data 01.10.2020 deri në kohën sa ne ishim në auditim (mars 2025).

Komisioni i rekrutimit nuk ishte mjaftueshëm i kujdesshëm në parandalimin e gabimeve dhe trajtimin e dëshmimeve nëse ato janë në përputhje me kriteret e konkursit.

Pozita me Zëvendësues/Ushtues detyre janë mbajtur për mbarëvajtjen e punës dhe efikasitetit të këtyre njësive dhe duke synuar që procesi i riorganizimit dhe ri sistemimit të nëpunësve të Ministrisë do të kryhet më shpejt dhe do të ketë emërimet të rregullta.

Ndikimi

Anashkalimi i kriterëve të vendosura në konkurs nga komisioni rekrutues, krijon mundësinë e pranimit të stafit me shkathtësinë dhe përvojën jo të duhur profesionale. Përderisa tejkalimet e afateve ligjore si Ushtues Detyre për një periudhë më të gjatë se një vit mund të ndikojë në cilësinë e performancës operationale të entitetit.

Rekomandimi A2 Ministri përmes menaxherit të personelit dhe komisioneve rekrutuese duhet të siguroj një proces të drejtë duke forcuar mekanizmat e kontrollit të brendshëm në proceset e ardhshme të rekrutimit. Po ashtu, duhet të ndërmerren të gjitha veprimet ligjore për mbulimin e pozitive me ushtrues detyre me pozita të rregullta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Kompensimi jo i plotë për punën jashtë orarit - kujdestaritë

Gjetja Ligji për Pagat në Sektorin Publik, Neni 36 përcakton se zyrtarët publik dhe kategoritë e tjera të të punësuarve që paguhen nga buxheti i shtetit përfitojnë kompensim në vlerë monetare apo me pushim për punën me kujdestari, punën gjatë natës dhe jashtë orarit të punës, punën në fundjavë, punën në ditët e festave zyrtare. Por, edhe mund të kërkojnë nga punëdhënësi që në vend të kompensimit në pagë, kompensimi të bëhet me ditë pushimi.

Ndërsa Rregullorja (MM) Nr. 10/2019 Për Orarin e Punës në Forcën e Sigurisë së Kosovës përcakton se orari i plotë i punës zgjat dyzet (40) orë në javë ose tetë (8) orë në ditë, dhe pjesëtarët e FSK-së janë të obliguar t'i përmbahen këtij orari. Orari i punës për pjesëtarët e FSK-së është prej orës 08:00 deri në orën 16:00, prej të hënës deri të premten.

Ministria në fund të vitit ka filluar të paguaj punën jashtë orarit të pjesëtarëve të FSK-së, duke i kompenzuar për periudhën Janar - Maj 2024. Megjithatë, pjesën më të madhe të vitit Ministria në mungesë të buxhetit e ka aplikuar kompensimin me ditë pushimi (jo plotësisht është kompenzuar edhe pushimi), për aq sa zhvillimi i aktiviteteve të Ministrisë të mos ndikohet apo pengohet. Po ashtu, si rezultat i sfidave për kompensimin e punës jashtë orarit për pjesëtarët e FSK-së ka filluar plotësim - ndryshimi i rregullores Nr.10/2019 për orarin e punës në FSK, mirëpo ende nuk ishte finalizuar.

Shkaku ishte mungesa e buxhetit të mjaftueshëm dhe rregullimi i paqartë i punës jashtë orarit. Arsye tjetër ishte edhe volumi i punëve dhe mungesa e personelit.

Ndikimi Kompensimi jo i plotë qoftë financiar apo me ditë pushimi përveç që ndikon në motivim të pjesëtarëve gjithashtu paraqet rrezik që Ministria të ballafaqohet edhe më tutje me padi gjyqësore që do të kenë ndikim financiar duke shkaktuar edhe shpenzime tjera gjyqësore/përmbartimore.

Rekomandimi C1 Ministri duhet të përshpejtoj procesin e rishikimit të rregullores aktuale për orarin e punës duke i përshatur me aktivitetin e saj dhe të sigurojë një rregullim të qartë në lidhje me kompensimin e punës jashtë orarit qoftë me pagesë apo me ditë pushimi në mënyrë që të gjithë pjesëtarët të cilët shërbejnë jashtë orarit të kompensohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë komunalitë ishte 44,777,100€, prej tyre ishin shpenzuar 42,573,955€ apo 95%. Ato kanë të bëjnë kryesisht me avance për mbrojtje dhe siguri, karburant për vetura, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve, furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare), furnizim me veshëmbathje, municion dhe armë zjarri, pajisje tjera etj.

Çështja C2 - Mangësi në menaxhimin e barnave

Gjetja

Rregullorja e MF - së Nr. 02/2013 - për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, në nenin 7 përcakton se të gjitha lëvizjet e pasurive jo financiare duhet të mbështeten në dokumente siç janë: fletë-pranimet, fletë-daljet dhe vetëm atëherë dokumentacioni do të konsiderohet i rregullt nëse dëshmohet me saktësi ndodhja e transaksionit dhe nëse përmban informata për shkakun e ndodhjes, datën dhe vendin e ndodhjes, llojin e pasurisë jo financiare, sasinë, vlerën dhe personat që kanë ekzekutuar transaksionin.

Menaxhimi i depoz së barnave nuk është bërë përmes sistemit e-pasuria. Dalja e barnave tek kampet tjera apo pacientët nuk bëhet përmes e-pasurisë, por bëhet në formë fizike, dhe si rezultat stoku në depon e e-pasurisë mbetet i pandryshuar. Stoket e barnave të skaduara ndër vite janë rritur dhe mbaheshin në ambiente të papërshtatshme në regjimentin e mjekësisë në FSK. Gjatë procesit të auditimit janë ndërmarrë veprime për zhvendosjen e barnave të skaduara në një ambient më të përshtatshëm.

Arsyeja pse nuk bëhet dalje e barnave nga e-pasuria nga moduli i spitalit ushtarak, është se depoja qendrore e FSK-së, ku pranohen të gjitha mallrat, nuk ka bërë dalje në modulën e e-pasurisë së spitalit ushtarak.

Ndikimi

Mungesa e informatave të sakta mbi gjendjen e stokut në depo, krijon një pasqyrë jo të qartë duke ndikuar në planifikimet e ardhshme për blerjen e tyre.

Rekomandimi C2

Ministri duhet të sigurojë se menaxhimit të barnave i paraprinë një vlerësim real i nevojave nga njësitë e kërkesave duke i shërbyer ata me informata të sakta mbi gjendjen e stokut në depo. Hyrje daljet e barnave nga depoja duhet të bëhen përmes e-pasurisë në mënyrë që të ketë pasqyrë të qartë gjatë gjithë kohës në mënyrë që mos të ketë grumbullim të barnave jashtë afatit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 88,041,260€, prej tyre ishin shpenzuar 84,853,764€ apo 96%. Ato kanë të bëjnë me avanse për investime, pajisje ushtarake, depo, garazha, pajisje të teknologjisë Informative, softuer dhe pajisje tjera.

Çështja A3 - Mangësi në fushën e prokurimit

Gjetja

Procedurat e prokurimit publik duhet të zhvillohen në përputhje me ligjin dhe rregulloret e prokurimit publik. Kriteret e vendosura në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të respektohen në plotëni. Ne identifikuam se:

- Në dosjen e tenderit "Ndërtimi i objektit të rojës në Devë-Gjakovë dhe Suharekë", te kërkesa 17 Raporti për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike - dëshmitë, pika B - ishte kërkuar që mjetet e transportit dhe punës të cilat sipas rregullave të komunikacionit regjistrohen duhet të jenë me afat të regjistrimit. Kjo duhet të dëshmohet me librezën e regjistrimit.

Ne identifikuam se OE fitues nuk e kishte plotësuar këtë kriter pasi që kamionët me të cilët kishte ofertuar ishin pa afat të regjistrimit (kjo vërehet nga librezat e regjistrimit të kamionëve të cilat ishin regjistruar për here të fundit në vitin 2022 apo para këtij viti); dhe

- Te Procedura e prokurimit "Ndërimi i qatisë dhe renovimi i objektit në Ministrinë e Mbrojtjes", validiteti i ofertave nuk e kishte mbuluar tërësisht periudhën siç kërkohet me neni 30.4 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Validiteti ishte zgjatur dy herë me nga 90 ditë, (22.09.2023 dhe 16.01.2024), megjithatë periudha prej 23.12.2023 deri më 15.01.2024 (25 ditë) nuk ishte e mbuluar me validitet të ofertave, si rezultat që AK nuk kishte kërkuar zgjatjen e tij menjëher pas skadimit të afatit.

Shkaqet e këtyre mangësive ishin te moskujdesi i komisionit vlerësues gjatë vlerësimit të kriterëve të kërkuara në dosjen e tenderit, kurse te validiteti moskujdesi ishte nga zyrtarët e prokurimit.

Ndikimi

Anashkalimi i kriterëve të vendosura në dosje të tenderit dhe moszgjatja me kohë e validitetit të ofertave krijon rrezik që proceset e prokurimit të mund të dështojnë si rezultat i mangësive përmbajtësore dhe administrative duke vonuar realizimin e projektve.

Rekomandimi A3

Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të prokurimit dhe komisioneve vlerësuese një proces vlerësim të drejtë të ofertave bazuar në kriteret e dosjes të tenderit dhe monitorim të rregullt e sistematik të afateve në lidhje me validitetin e ofertave kur proceset e vlerësimit të tenderëve për arsye të justifikueshme zgjasin përtej afateve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 317,522,558€, pasurive jokapitale është 2,453,238€, si dhe e stoqeve 3,650,822€.

Çështja B1 - Mangësi në menaxhimin e pasurive përmes sistemit e-Pasuria

Gjetja

Sipas Rregullores Financiare MF nr. 02/2013 - Për Menaxhimin e pasurisë jo financiare, në nenin 22 pikën 3 përcaktohet që të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit. Kurse neni 24 i të njëjtës rregullore pika 3 përcakton se: paraqitja e pasurisë jo financiare në Pasqyrat financiare vjetore do të prezantohet në bazë të vlerës kontabël neto. Ne identifikuam se:

- Edhe këtë vit në sistemin e-Pasuria nuk ishte bërë zhvlerësimi i një pjese të pasurive nën 1,000€ (pasuria që nuk është zhvlerësuar ka vlerë prej 1,096,080€). Prej tyre figuronin si material shpenzues 416,510€, ku një pjesë e tyre iu takon edhe stoqeve. Ministria nuk kishte informata të sakta se sa do të duhej të ishte vlera e zhvlerësimit të këtyre pasurive; dhe
- Po ashtu, kemi pasuri të cilat figurojnë në regjistrin e pasurive nën 1000€ me përshkrim të gabuar si në rastin, Dell 32 4K Gaming Monitor janë blerë (6 copë) në vlerë totale 3,646€ kurse në sistem janë regjistruar vetëm (5 copë) për më pak në vlerë 607€ dhe janë si Mobilje (Tavolinë pune 160x70x73.5cm). Dell Vostro (125 copë) në vlerë totale 77,060€ ishin regjistruar si material shpenzues (Jelek me numër për vrapim). Canon EOS RP Body (5 copë) në vlerë totale 4,850 ishin regjistruar si material shpenzues dhe në sistem figuronin si (Korniza druri dhe xhame). Më tutje kosë për kositje bari me benzinë (8 copë) në vlerë totale 3,600€ janë regjistruar si material shpenzues (Diodat e Alternatorit-Traktor Motokos Viking) dhe Televizora Telefunken (10 copë) në vlerë totale 5,850€ janë regjistruar si material shpenzues (Filter i Vajit-Ngarkues AS 12B).

Gjatë vizitës që i kemi bërë depove qendrore sa i përket ndryshimit të emërimit të asetëve, kemi vërejtur se depoistët e bëjnë pranimin dhe regjistrimin e mallit sipas emërimit të asetëve mirëpo, ndryshon emërtimi tek raporti sipas vlerës, por nuk ndryshojnë vlerat. Po ashtu, gjatë vizitave në teren (Istog dhe Ferizaj) disa pasuri që ishin shpërndarë në vitin 2024 nuk kishin pasur barkode.

Edhe këtë vit MM nuk kishte identifikuar shkaqet për gjenerimin e raporteve me përshkrime dhe zhvlerësime të gabuara të pasurive nën 1000€ edhe pse ne kemi pranuar shkresat-kërkesë për ndihmë që ishin bërë nga MM drejtuar mirëmbajtësit të sistemit të e-pasurisë për zgjidhjen e këtij problemi.

Ndikimi

Mos zhvlerësimi i pasurive ndikon që informatat e prezantuara në PFV, të jenë jo të plota dhe jo të sakta dhe si rrjedhojë kemi mbivlerësim të pasurive neto. Në anën tjetër mosfunksionimi siç duhet i sistemit e-pasuria, vështirëson menaxhimin dhe kontrollin e pasurive në dispozicion, krijon konfuzion në lidhje me llojin dhe klasifikimin e pasurive dhe rrit rrezikun e humbjes dhe keqpërdorimit të pasurive.

Rekomandimi B1

Ministri duhet të siguroj përmes menaxherit të financave që pasuritë nën

1000€ janë prezantuar në mënyrë të plotë dhe të saktë në PFV. Po ashtu, Ministria duhet të ndërtojë një bashkëpunim efektiv me mirëmbajtësin e sistemit e-pasuria për eliminimin e gabimeve gjatë tërë vitit në mënyrë që sistemi e-pasuria të gjenerojë me saktësi pasurinë e regjistruar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.5 Detyrimet kontingjente

Pasqyra e detyrimeve kontingjente në fund të vitit 2024, ishte 1,552,517€.

Çështja A4 - Prezentim jo i saktë i detyrimeve kontingjente

Gjetja Rregullorja MF nr.01/2017, Neni 18 obligon Organizatat buxhetore të raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente në PVF. Detyrim kontingjent është një detyrim i cili materializohet vetëm pas ndodhjes së disa ngjarjeve të caktuara në të ardhmen. Ne identifikuam se detyrimet kontingjente ishin mbivlerësuar për 11,925€ si në vijim:

- Lënda C.nr.8078/2021, në listën e detyrimeve kontingjente ishte prezantuar në vlerë prej 10,032€ ndërsa vlera e saj në dokumentet burimore ishte 4,972€, (me një mbivlerësim prej 5,240€); dhe
- Lënda C.nr.1408/24, në listën e detyrimeve kontingjente ishte prezantuar në vlerë 8,021€ ndërsa sipas aktgjyqimit të fundit të gjykatës vlera e aprovuar e kontestit ishte 1,336€, kurse pjesa tjetër ishte refuzuar si e pabazë (me një mbivlerësim prej 6,685€).

Mos përditësimi i detyrimeve kontingjente nga zyra ligjore me të dhënat e fundit nga proceset kontestimore ishte shkaktari kryesor i mbivlerësimit të detyrimeve kontingjente.

Ndikimi Prezantimi jo i saktë ka ndikuar në mbivlerësim të detyrimit dhe paraqet gjendjen jo reale në Pasqyra Vjetore Financiare.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të siguroj një kordinim në mes zyrës ligjore dhe ZKF-së në mënyrë që detyrimet kontingjente të jenë të përditësuara në fund të vitit me qëllim që të prezantohen drejtë dhe në përputhje me kërkesat e rregullores për Raportim Vjetor Financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	153,049,911	175,175,120	169,781,668	177,943,593	137,592,675
Grante Qeveritare - Buxheti	153,049,911	175,175,120	169,781,668	177,943,593	137,592,665
Donacionet e jashtme	0	0	0	0	10

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 22,125,209€. Ndryshimet buxhetore kanë ardhur si rezultat i vendimeve të qeverisë.

Në vitin 2024 Ministria ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 169,781,668€ me një përqindje më të lartë prej 10% në raport me vitin paraprak. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	153,049,911	175,175,120	169,781,668	177,943,593	137,592,675
Pagat dhe mëditjet	42,320,051	42,356,760	42,353,950	36,754,944	29,121,779
Mallrat dhe shërbimet	51,040,600	43,629,100	41,666,736	51,294,124	13,788,259
Komunalitë	1,148,000	1,148,000	907,219	862,240	782,841
Investimet Kapitale	58,541,260	88,041,260	84,853,764	89,032,284	93,899,796

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 36,709€, me vendime të Qeverisë si rezultat i mbulimit të deficitit buxhetor në këtë kategori. Realizimi i buxhetit final në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve ishte 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 7,411,500€. Zvogëlimi në vlerë 6,680,500€ vjen si rezultat i vendimeve të Qeverisë si kursime buxhetore përkundër kërkesës së Ministrisë së Mbrojtjes për transfer të këtyre mjeteve të kategoria e investimeve kapitale. Kurse mjetet në vlerë prej 731,000€ i ishin transferuar Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit të dy Ministrive për pagesën e shpenzimeve për Atashetë e Mbrojtjes nëpër Ambasadat e Kosovës. Buxheti final i kësaj kategorie ishte shpenzuar 96%;
- Buxheti final dhe fillestar për komunalitet ishte 1,148,000€. Realizimi i buxhetit ishte 79% apo 907,219€; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 29,500,000€. Rritja e buxhetit në investime kapitale vjen nga vendimet e Qeverisë për mbulimin e obligimeve kontraktuale, pagesën e obligimeve doganore në vlerë 6,500,000 dhe 23,000,000€ për blerjet e reja strategjike me qëllim të ngritjes së Industrisë së mbrojtjes. Realizimi ishte 96%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Ministria në vitin 2024, ka realizuar të hyra në vlerë mbi 30,359€ si në vijim:

- Të hyrat në vlerë prej 23,200€ ishin nga trajnimet në mes të QNTKSH (Qendra ndërkombëtare e trajnimeve të kërkim shpëtimit) - FSK, Ekipit të Kërkim Shpëtimit të Holandës si dhe ekipit “HEAT” nga Mbretëria e Bashkuar, kurse të hyrat në vlerë prej 1,050€, ishin nga realizimi i trajnimit në mesë të QNTKSH - FSK dhe kompanisë “Lazarus Trajning LTD nga Mbretëria e Bashkuar; dhe
- Po ashtu, kishte edhe të hyra nga viti i kaluar si kthimet e pagave në vlerë 3,556€, kthimi i avancit 670€, kthimi i mjeteve nga Atasheu në vlerë 1,038€ dhe gjobat e trafikut në vlerë 845€ që ishin realizuar sipas Rregullores (MM) Nr.04/2023 për autorizimet e policisë ushtarake në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	135,097	135,097	30,359	170,332	165,919
Të hyrat jo tatimore	135,097	135,097	25,105		
Të hyrat tjera	0	0	5,253	170,332	165,919

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2023 ka rezultuar me pesë (5) rekomandime. MM kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Gjithashtu, ka dorëzuar Raportin e progresit mbi zbatimin e rekomandimeve me 30 shtator dhe 15 mars.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, ne kemi identifikuar se dy (2) rekomandim ishte zbatuar, një (1) rekomandim ishte përsëritur, dhe dy (2) ishin pjesërisht të zbatuara siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të rishikojë rregulloret aktuale për orarin e punës duke i përshtatur me aktivitetin e saj dhe të sigurojë një rregullim të qartë në lidhje me kompensimin e punës jashtë orarit me ditë pushimi në mënyrë që të gjithë pjesëtarët të cilët shërbejnë jashtë orarit të kompensohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ministria deri në muajin maj kishte bërë kompenzimin e zyrtarëve përderisa ende nuk kishte rishikuar rregulloret aktuale lidhur me kompenzim-pushim.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherëve të kontratave, se pranimi i barnave bëhet sipas afateve të dakorduara me qëllim që barnat të jenë në disponim me kohë, në të kundërtën duhet të aplikohen penalet për vonesa. Po ashtu, planifikimit dhe menaxhimit të stokut duhet ti paraprijë një vlerësim real i nevojave nga njësitë e kërkesave duke i shërbyer ata me informata të sakta mbi gjendjen e stokut në depo. Hyrje daljet e barnave nga depoja duhet të bëhen përmes e-pasurisë në mënyrë që të ketë pasqyrë të qartë gjatë gjithë kohës.	Janë bërë disa korrigjime, mirëpo prapë kemi identifikuar probleme tjera në menaxhimin e barnave.	Pjesërisht i zbatuar
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri në koordinim me FSK-në duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet konkrete dhe me kohë për krijimin e parakushteve të infrastrukturës për të mundësuar përmbushjen e secilës kontratë të nënshkruar. Po ashtu, menaxherët e kontratave të bëjnë menaxhimin e duhur dhe pagesat të bëhen vetëm për punët e kryera sipas kushteve të parapara me kontratë.	Gjatë vitit 2024 nuk kemi identifikuar raste të tilla.	I zbatuar
4.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave që pasuritë nën 1000€ janë prezantuar në mënyrë të plotë dhe të saktë në PFV. Po ashtu, Ministria duhet të ndërtojë një bashkëpunim efektiv me mirëmbajtësin e sistemit e-pasuria për eliminimin e gabimeve gjatë tërë vitit në mënyrë që sistemi e-pasuria të gjenerojë me saktësi pasurinë e regjistruar.	Kemi identifikuar probleme të natyrës së ngjashme në sistemin e-pasuria.	Nuk është adresuar
5.	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit ligjor, siç është përcaktuar me ligj, në mënyrë që të shmangen kostot shtesë si pasojë e pagesave me procedura përmbareme apo gjyqësore.	Këtë vit nuk kemi identifikuar raste të tilla.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Ariana Berisha Rexhëbeqaj, Udhëheqëse e ekipit




Adelina Selmani, Anëtare e ekipit



Antigona Çitaku, Anëtare e ekipit



Altina Selimi Palushi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Prezentim jo i saktë i detyrimeve kontingjente	Rreth lëndës C.nr. 1408/2024, nuk pajtohem me të gjeturën, për arsye si më poshtë: Sipas Ligjit për Procedurën Kontestimore, si vlerë e objektit të kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore, e përcaktuar nga paditësi në padi/kërkesëpadi. Në bazë të shkresa të lëndës C.nr. 1408/2024, paditësi në padi ka kërkuar vlerën total prej 8,021 euro për kompensim të diferencës në pagë (ashtu edhe siç është pasqyruar në detyrimet kontingjente), ndërkaq vetëm sipas Aktgjykimit të shkallës së parë të Gjykatës Themelore (dhe jo të fundit në procedurë gjyqësore) paditësit i është aprovuar pjesërisht kërkesëpadia, ashtu që në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i është njohur vetëm vlera prej 1,336, 86 euro, ndërsa në pikën II të dispozitivit, paditësit i është refuzuar vlera prej 6,936.15 euro.	Sipas Standardeve detyrimet kontingjente janë pretendime dhe nuk mundet me saktësi të plotë të vlerësohet ndodhja e tyre. Megjithatë, në rastin e Ministrisë ne kemi një aktgjykim në lidhje me këtë pretendim dhe vlera e aktgjykimit duhet të konsiderohet më e përafërt për tu prezantuar në Pasqyra Financiare se sa vlera fillestare e pretendimit të klientit e paraqitur në padi. Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane Ministry of Defense

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MBROJTJES - MINISTARSTVO ODBRANE - MINISTRY OF DEFENSE	
No. Prot: 2646	No. / F. d. d. 2
No. Prot: 2646	No. / F. d. d. 2
Data: 07.05/2025	
Prishtinë / a	

DATE/A:	07.05.2025
REFERENC-Ë:	3/302/2025
PËR/ZA/TO:	Zyrën Kombëtare të Auditimit Adresa: Lagjja Arbëria, Rr. Ahmet Krasniqi, 210 - Prishtinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Ejup Maqedonci - Ministër i Mbrojtjes, MM
NGA/OD/FROM:	Gafurr Dugolli - Sekretar i Përgjithshëm, MM
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Letër e Konfirmimit Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kemi pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Mbrojtjes, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem kryesisht me gjetjet dhe rekomandimet, por kërkojmë të adresohet komenti i bashkëngjitur kësaj shkrese për të cilin vlerësojmë se duhet të merret në konsideratë edhe një herë nga ekipa e auditimit;
- Pas pranimit të Raportit final, do të perpiqemi planin e veprimtimit për zbatimin e rekomandimeve dhe duke ju përmbajtur afate ve kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Komenti ynë:

Çështja A4- Prezantimi jo i saktë i detyrimeve kontingjente

Rreth lëndës **C.nr. 1408/2024**, nuk pajtohem me të gjeturën, për arsye si më poshtë:

Sipas Ligjit për Procedurën Kontestimore, si vlerë e objektit të kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore, e përcaktuar nga paditësi në padi/kërkesëpadi.

Në bazë të shkresës të lëndës **C.nr. 1408/2024**, paditësi në padi ka kërkuar vlerën total prej **8,021 euro** për kompensim të diferencës në pagë (ashtu edhe siç është pasqyruar në detyrimet kontingjente), ndërkohë që sipas Aktgjykimit të shkallës së parë të Gjykatës Themelore (dhe jo

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.